



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHTIMES

MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA  
INFORMISANJE

Data/Datum/Date:	22. 1. 2024
Nr./Br./No	02-19
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Shtimes
Përmes/Preko/Through:	Qemajl Aliu, kryetari i komunës së Shtimes
Nga/Od/From:	Lulzim Sahiti, koordinator i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
Lënda/Predmet/Subject:	Raporti i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023

Kuvendi i Komunës së Shtimes, më 28. 3. 2022 ka nxjerr Vendimin nr.01.60 për zgjedhjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Shtime.

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) funksionon në kuadër të komunës si organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë në bashkëpunim me policinë dhe anëtarët tjerë të KKSBB-së, të cilët analizojnë dhe shqyrtojnë të gjitha çështjet e sigurisë së komunitetit për të mirën e të gjithë qytetarëve që jetojnë në komunë.

MPB-ja përmes Divisionit për Siguri në Bashkësi (DSB), monitoron funksionimin dhe aktivitetet e KKSBB-së në komunën tonë në mënyrë periodike dhe informohet me disa nga shqetësimet më të shpeshta të sigurisë në bashkësi me të cilat përballen qytetarët në përgjithësi.

KKSBB-ja është mekanizëm i cili bënë koordinimin ndërinstitucional për ndërmarrjen e masave preventive, prandaj KKSBB është instrument për të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e qytetarëve.

Më 16. 3. 2023 është mbajtur mbledhja e parë e KKSBB-së. Në këtë mbledhje fillimisht është konstatuar lista e pjesëmarrjes në mbledhje të anëtarëve të KKSBB, si dhe me propozim të

nënkyetarit të Komunës së Shtimes, Faruk Beqa është miratuar Strategjia e KKSBS-së dhe Plani i Veprimit 2023-2025.

Sipas rendit të ditës është dhënë informacion nga zyrtarët e Stacionit Policor në Shtime rrëth gjendjes së sigurisë në komunën tonë.

Më pastaj, për çështjen e sigurisë, përkatësisht për vjedhjet e fundit nëpër shkolla e ka ngritur si problem në vete, drejtoresha e Arsimit, Yllka Fejzullahu, ku lidhur me këtë çështje dhe dukuri tjera negative kanë folur gjithashtu nënkyetari Faruk Beqa, përgjegjësi i Zyrës Komunale për Kthim dhe Komunitete, Ibrahim Demiri dhe imami i Këshillit të Bashkësë Islame, Skender Baftiu.

Mbledhja e dytë e KKSBS-së, e ftuar më 25. 4. 2023, nuk është mbajtur për shkak të mungesës së korumit dhe është shtyrë për kohë të pacaktuar.

Më pastaj, mbledhja e dytë është mbajtur më 23. 5. 2023. Të pranishmit në këtë mbledhje në përgjithësi diskutuan për sigurinë e përgjithshme në Komunën e Shtimes. Ndërsa për pikën e dytë të rendit të ditës nuk u diskutua fare, ngase mungoi drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, Kastriot Shabani.

Mbledhja e tretë e KKSBS-së, është mbajtur më 30. 6. 2023 dhe në mungesë të kryetarit të Komunës, mbledhjen e udhëheqi Kastriot Shabani, drejtor i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, ku i njoftoi të pranishmit me tri pikat rendin e ditës.

Në këtë mbledhje është diskutuar për sigurinë e përgjithshme në komunën e Shtimes si dhe drejtori për Zhvillim Ekonomik, Kastriot Shabani ka dhënë një informatë për punën gjashtëmuore në dikasterit e tij. Ndërsa, komandanti i Stacionit të Policisë në Shtime, toger Haxhi Behluli, gjatë kësaj mbledhje ka bërë të ditur se situata në komunën tonë është stabile dhe e qetë.

Në këtë takim gjithashtu është diskutuar rrëth përgatitjeve dhe ngritjes së gatishmërisë gjatë sezonit të verës për shkak të ngritjes së temperaturave.

Në mbledhjen e IV-të, të KKSBS-së, e cila është mbajtur më 19. 10. 2023, janë diskutuar tri pika të rendit të ditës.

Fillimisht, anëtarët e pranishëm të KKSBS-së, i ka përvendetur nënkyetari i Komunës, Faruk Beqa. Në këtë mbledhje gjendja e sigurisë në komunën e Shtimes u cilësua e qetë dhe stabile. Ndërsa, komandanti i Stacionit të Policisë në Shtime, Haxhi Behluli ka prezantuar ngjarjet që kanë ndodhur gjatë periudhës tetëmuore dhe ka raportuar para anëtarëve të KKSBS-së.

Për pikën e dytë të rendit të ditës, që kishte të bënte rrëth aktiviteteve të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ka informuar të pranishmit drejtori i këtij dikasteri, Bardhyl Rushiti.

Po ashtu, anëtarët e KKSBS-së paraqitën vërejtjet e tyre për dukuritë që i shqetësojnë qytetarët e komunës së Shtimes.

Mbledhja e pestë (V) e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi është mbajtur më 2 nëntor 2023.

Në këtë mbledhje të radhës të KKSBB-së ndër të tjera është diskutuar rreth gjendjes së sigurisë në komunën e Shtimes, ku krahasuar me të njëjtën periudhë kohore nga viti i kaluar u cilësua më stabile dhe e qetë.

Farku Beqa, nënkyrjetar i komunës së Shimes, njoftoi të pranishmit me rendin e ditës. Ndërsa, komandanti i Stacionit Policor në Shtime, Haxhi Behluli prezantoi statistikat gjatë tre muajve të fundit, duke e cilësuar situatën në komunë gjatë kësaj periudhe shumë stabile.

Ndërsa, Lorik Ramaj nga FSK, tha se nga 16 komunat sa monitoron ekipi i tij, Komuna e Shtimes mund të cilësohet si njëra nga komunat model sa u takon mbledhjeve të KKSBB-së por edhe marrjen e vendimeve dhe kërkësave që janë diskutuar në këto mbledhje.

Në këtë mbledhje nga të pranishmit u diskutua edhe për shqetësimet të ndryshme të qytetarëve të komunës sonë.

Në mbledhjen e VI-të dhe të fundit për këtë vit, të mbajtur më 12 dhjetor 2023, KKSBB, është diskutuar për pesë pika të ditës.

Komandanti i Stacionit Policor, Haxhi Behluli, tha se gjendja e sigurisë në komunën e Shtimes është mjaft stabile ku u bazua në statistikat e raportit 11 mujor të vitit 2023.

Ndërsa, u.d. drejtori i QKMF-së "Dr. Vezir Bajrami", Ilaz Kadrijaj njoftoi se së shpejti do të hapet pika e katërt e Qendrës së Mjekësisë Familjare, në fshatin Godanc. Gjithashtu, në bazë të raportit, Kadrijaj tha se totali i vizitave mjekësore gjatë kësaj periudhe ishte mbi 111 mijë qytetarë, ndërsa mbi 223 mijë qytetarëve iu ofruan shërbime mjekësore.

Nga përgjegjësi i Njësisë së Ujësjellësit Rajonal "Prishtina", Ali Ademaj është bërë e ditur se disa individë po mundohen të bëjnë propagandë që uji në komunën tonë nuk është për konsumim, por që sipas tij kjo nuk është e vërtetë.

### Sfidat dhe shqetësimet:

Në kuadër të gjashtë mbledhjeve të KKSBB-së është diskutuar për shqetësimet dhe sfidat e ndryshme që ballafaqohen në jetën e përditshmë qytetarët tanë siç janë: Vjedhjet, siguria e trafikut, parandalimi i drogave, siguria e nxënësve në shkolla, mbyllja e lokaleve pa licencë, qentë endacak, zjarrevënya nëpër fusha, mungesa e zjarrfikësve, lëvizja e ngarkësave të mëdha afér shkollave (SHF "Emin Duraku"), furrat e gëlqeres, ankesa për trafikun, rreziku nga substancat narkotike, shkeljet në trafik, gjendja e gatishmërisë në sezonën e korrje-shirjes, rreziku nga lodrat e fëmijëve, ndërprerja e ndriçimit publik, vendosja e kamerave të sigurisë nëpër shkolla, rreziku nga liqeni artificial "Mjellmat", ndotja e ambientit nga mbeturinat, rreziku nga mungesa e kapakëve të puseta, dhuna në familje, deminimi i zonave të minuara etj.

### Veprimet dhe masat konkrete nga Komuna:

- Në bashkëpunim me "The Church of Jesus Christ of Latter-Day Saints" dhe policinë është hapur "Dhoma mike", në Stacioni Policor të Shtimes. Gjithashtu nga policia janë mbajtur ligjërata nëpër shkolla për vetëdijësim kundër dhunës në familje;
- Policia ka përgtitur planin operativ për parandalim të vjedhjeve me emrin "Preventiva". Ky plan ka ndikuar pozitivisht në rënien të vjedhjeve;
- Policia ka mbajtur trajnime për rrezikun nga trafiku nëpër shkolla;
- Policia ka bërë kontrollimin në dhjetë lokale prej të cilave katër kanë rezultuar të jenë pa licenc;

- Policia ka mbajtur fushatë vetëdijësuese kundër zjarrvënies;
- Komuna ka planifikuar buxhetin pér vitin 2024 dhe rritjen e numrit tē zjarrfikësve;
- Në raste tē reshjeve atmosferike liqeni “Mjellmat” dhe disa pellgje mbikëqyren herë pas here nga policia;
- Drejtoria e Shërbimeve Publike së bashku me policinë ka hartuar planin operativ pér sigurinë në shkolla, ku veprojnë policët me rroba civile dhe pér një orë kur nxënësit e frekuentojnë më së shumti këtë rrugë është bërë ndalim-qarkullimi i kamionëve me ngarkesa tē rënda.
- FSK ka bërë deminimin e zonës në fshatin Belinc tē Shtimes etj.
- Inspektorët komunalë tē ndihmuar edhe nga policia kanë rrënuar furrat e gëlqeres me qëllim tē ruajtjes së ambientit;
- Pér çështje tē sigurisë në disa institucione edukativo-arsimore janë vendosur alarmet dhe kamerat vrojtuese etj.

Përndryshe, konform Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL pér Këshillat Komunale pér Siguri në Bashkësi, janë mbajtur gjashtë mbledhje tē rregullta tē KKSB-së, prej të cilave tri janë mbajtur në gjashtëmujorin e parë tē vitit kalendarik. Të gjitha mbledhjet janë zhvilluar në ambiente tē Komunës së Shtimes dhe pér secilin takim është mbajtur procesverbal, tē cilët janë publikuar edhe në ueb-faqen zyrtare tē Komunës së Shtimes.